



Me rastin e 10 Majit, Ditës shqiptare të Drejtësisë, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Klinikën e Ligjit të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (FDUT), me mbështetjen e Programit të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST), organizojnë “debatin imitues” të bashkëbisedimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë të SHBA, Antonin Scalia dhe Stephen Breyer, mbi mbështetjen në ligjin e huaj në gjykimet kushtetuese të kësaj gjykate.

Ky bashkëbisedim, i përshtatur në gjuhën shqipe me pak shkurtime, vjen përpara jush nën interpretimin e studentëve të Klinikës së Ligjit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Bashkëbisedimi imitues zhvillohet pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Salla e Gjyqit Imitues, dt. 09 maj, ora 10:00.

Vitet e fundit, një nga çështjet më të debatueshme në Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë nëse, duhet të mbështetesh apo jo, në vendimet gjyqësore ose ligjet e vendeve të tjera, për të vendosur për çështje kushtetuese Amerikane? Në opinionet gjyqësore dhe në fjalimet e tyre, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë shprehur pikëpamje krejtësisht të ndryshme mbi këtë çështje. Megjithatë, ka shumë raste të përdorimit të ligjit të huaj. P.sh., Gjykata e Lartë u bazua në ligjin e huaj për të konkluduar se, dënimi me vdekje në SHBA nuk duhet aplikuar për personat nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Në 13 janar 2005 u zhvillua diskutimi ballë për ballë, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Antonin Scalia dhe Stephen Breyer, mbi vlefshmërinë e referimit në ligjin e huaj në gjykimin kushtetues në SHBA. Ky bashkëbisedim, i përshtatur në gjuhën shqipe, me pak shkurtime, vjen përpara jush nën interpretimin e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Gjyqtari Scalia: Mirë, shumica e këtyre pyetjeve duhet t'i drejtohen Gjyqtarit Breyer, sepse unë nuk e përdor ligjin e huaj në interpretimin e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Unë do ta përdorja atë në interpretimin e traktateve.

Gjyqtari Breyer: Nëse unë kam një rast të vështirë dhe një qenie njerëzore e quajtur gjykatës, megjithëse nga ndonjë vend tjetër, është marrë me një problem të ngjashëm, pse nuk duhet të lexoj se çfarë ka thënë ky gjykatës? Nuk është detyruar për mua, por unë mund të mësoj diçka.